

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	07.09.2020
Për/ Za/ To:	“Artech” sh.p.k.;
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesave

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/ A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Artech” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “Artech” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK -së, të datës 28.08.2020 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së. të publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin e marrur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111**.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 28.08.2020 ka bërë Njoftimit mbi vendimin e AK –së lidhur me me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”**, me Nr. të Prok: **616 20 012 111**.

Me datë 28.08.2020, **Operatori Ekonomik: “Artech” sh.p.k.**; kanë bërë kërkesë për çasje në dokumente zyrtare të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Me datë: 02.09.2020, **Operator Ekonomik: “Artech” sh.p.k.**; ka bërë kërkesë për rishqyrtim me c’rast pretendimet e tyre i kanë mbështetur si në vijim:

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me veprimet dhe/apo mos veprimet e veta ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht:

Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 1, 2 dhe 6.vi

Nenin 28 – Specifikimet Teknike

Nenin 51 – Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Nenin 52 – Njoftimi i kritereve për dhënie të kontratës

Nenin 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënie të Kontratave , paragrafi 3

Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 4

Nenin 60 - Kriteret për Dhënie të Kontratës, paragrafin 1.1

Nenin 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 1 dhe 2.5

Nenin 70 – Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Dhe dispozitat nënligjore nga Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik dhe atë dispozitat:

Nenin 20 – Specifikimet Teknike

Nenin 26 – Kriteret e përzgjedhjes, paragrafët 1.2 dhe 26.8

Nenin 28 – Kriteret e dhënies së kontratës

Nenin 41 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Njoftimin e KRPP-së të datës 26.06.2020 në platformën elektronike të prokurimit, për sqarimin e dispozitave ligjore të LPP-së:

Neni 69 i LPP-së – Aftësitë teknike dhe / ose profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK ka vepruar kundërligjshëm duke na eliminuar ne si grup i OE-ve të përgjegjshëm me çmimin më të lirë dhe duke e shpërblyer një grup të OE-ve të papërgjegjshëm me çmimin më të shtrenjtë, në kundërshtim me kriterin për dhënie të kontratës, në kundërshtim me FTD nenin 31.3 dhe Nenin 52 dhe 60 të LPP-së dhe 28 të RRUOPP-së.

Grupi i OE-ve të shpërblyer me kontratë janë të papërgjegjshëm sepse të njëjtit nuk i kanë plotësuar disa nga kriteret e vlerësimit dhe atë si vijon:

- Certifikata ISO 9001:2015 me numër ER-236-QMS nga OE Cimi Electronic shpk e ka afatin e skaduar të vlefshmërisë, në kundërshtim me kërkesën e AK-së se kjo certifikatë duhet të ketë vlefshmëri minimumin deri në fund të vitit 2020! Asnjë email apo letër dashurie nuk e zëvendëson mungesën e certifikatës në fjalë, ndonëse AK mundohet ta mbulojë shkeljen e vete ligjore me një email ku thuhet se nëse kompania dëshiron mund të kërkojë auditim dhe pastaj do të mund të ri certifikohet edhe për një vit. Vlenë të ceket se kjo certifikatë e prezantuar nga ky OE nuk ka

asgjë të bëjmë me lëndën nga ky AP, por me pajisje të sigurisë siç janë Kamerate, sistemet elektrike dhe sistemet automatike dhe nëse ky “kriter” zbatohet për një OE të caktuar, i njëjti sipas Nenit 7 të LPP-së duhet zbatuar për të gjithë OE-të.

PROVË: Certifikata ISO 9001:2015 me numër ER-236-QMS nga OE Cimi Electronic shpk dhe emaillet me EAS ICC të datës 01.06.2020 dhe 02.06.2020

Ky kriter nga AK është përdorur dhe ka shërbyer për të ju “pamundësuar” shumë OE-ve tjerë pjesëmarrjen në këtë AP, sepse nuk e kanë plotësuar këtë kriter dhe tani të shpërblehet një OE pa e plotësuar këtë kriter është e jo e drejtë, në kundërshtim me Nenin 7, 51, 56, 59, 69 dhe 70 të LPP-së si dhe 26 dhe 41 të RRUOPP-së dhe Njoftimin e KRPP-së të datës 26.06.2020 në platformën elektronike të prokurimit, për sqarimin e dispozitave ligjore të LPP-së Nenin 69 i LPP-së – Aftësitë teknike dhe / ose profesionale ku sqarohet se si duhet interpretuar.

Ky Grup i OE-ve sipas këtij kriteri të përcaktuar nga AK është i papërgjegjshëm dhe bazuar në RRUOPP Neni 26.5.C ky grup i OE-ve NUK KALON, bazuar në Kriteret e Përzgjedhjes. As bazuar në Nenin 72 të LPP-së dhe Nenin 39 Sqarimi i tenderit të RRUOPP-së, në rastin kur nuk mungon Certifikata ISO por e njëjta nuk i plotëson kriteret e përcaktuara NUK MUND të kërkojnë sqarime dhe me këtë rast OE nuk mund as ta sqarojë apo plotësojë tenderin me ndonjë dokument shtesë apo dëshmi ekuivalente.

Grupi i OE-v të shpërblyer me kontratë, ka prezantuar një Autorizim: “Manufacturer’s Authorization Form” të datës 04.05.2020 nga një kompani të quajtur TPVISION për Televizion të markës Philips me çka ky OE ka konkurruar dhe ka prezantuar katalogun, ndonëse kjo kompani nuk është as përfaqësues i Philips për Kosovë, as për Bullgari ku edhe e ka selinë. Pra si mund të japë autorizim një kompani për një markë tregtar apo prodhues tjetër, për një ofertues, pa qenë fare as pronar, as përfaqësues e as autorizuar për të lëshuar një dokument të tillë, e aq më tepër të pranohet nga AK si dokument i vlefshëm. Kjo kompani në këtë autorizim pretendon të jetë prodhues i televizioneve Philips, por jo që nuk është vetë Philips, por asnjë dëshmi të vetme nuk e prezanton se përfaqëson kompaninë Philips dhe si e tillë është e pavlefshme, mos qoftë komplet e FALSIFIKUAR, por në nuk jemi ekspertë e as të thirrur për të dhënë konstatime të tilla, sepse na mungon kapaciteti që posedon AK.

PROVË: Dokumenti i datës 04.05.2020 me titull Manufacturer’s Authorization Form nga TPVISION dhe katalogu nga Philips për TV 4K UHD LED Android

Gjithashtu në katalogun e prezantuar nga grupi i OE-ve të shpërblyer me kontratë, për TV Philips 75US7354/12 askund nuk ceket sy ky TV do të liferohet me kapacitet 2GB siç është kërkuar nga AK, pra shpërblehet një OE i cili nuk e ka plotësuar as Specifikacionin Teknik të Detyrueshëm nga Aneksi 1 i dosjes së tenderit, veprim ky në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së dhe atë 20 të RRUOPP-së.

PROVË: katalogu nga Philips për TV 4K UHD LED Android

AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 56 paragrafin 3 të LPP-së, citojmë nenin në fjalë: **“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.”**

AK duke u bazuar në një dokument nga Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale me titull “Licencë Veprimtarie” të prezantuar nga OE Eramed, anëtar i grupit të OE-ve, e përdor si kriter vlerësues për ta arsyetuar eliminimin tonë nga ky AP. Me Nenin 56.3 të LPP-së dhe Nenin 26 të RRUOPP-së, sepse ky OE e ka prezantuar ISO Certifikatën

9001:2015 me afat vlefshmërie deri më 12.09.2021, siç është kërkuar nga AK dhe Licenca nga AKPPM nuk mund të përdoret si kriter për eliminim.

PROVË: Certifikata ISO 9001:2015 nga OE Eramed ntp me afat të vlefshmërisë deri më 12.09.2021

Ne formularin standard B45 të pranuar nga AK na njofton si arsyetim se pse jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit është edhe “vërtetimi nga zyrtarët e AK-së” se ne “kemi falsifikuar” katalogun duke kryer vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës Neni 390 dhe 391. Kjo nuk qëndron dhe është shpifje dhe Keqpërdorim i Pozitës dhe Autoriteti Zyrtar nga këta zyrtarë të AK-së dhe për ta vërtetuar këtë fakt i paraqesim AK-së komunikimet zyrtare me prodhuesi ACER, emailt e datave 27.04.2020, 16.04.2020, 04.04.2020, nga kemi pranuar zyrtarisht nga ACER katalogun e produktit laptop Acer Aspire 3 me Part Numer A315-54K-361G, ofertën financiare (e kemi mbuluar), afatin e liferimit, Autorizimin nga Prodhuesi, etj. si dhe katalogun për laptopin ACER Aspire 3.

Provë: emailt e datave 27.04.2020, 16.04.2020, 04.04.2020 (4 faqe) dhe Katalogu nga ACER për laptop Aspire 3 me Part Numer A315-54K-361G

Për ta vërtetuar edhe më tutje se NUK KEMI të bëjmë me falsifikimi të katalogut, por se katalogu i prezantuar nga ne për Laptop Acer Aspire 3 me Part Numer A315-54K-361G, kësaj kërkesë për rishqyrtim i bashkëngjisim në cilësi të provave edhe emailin e datës 01.09.2020 nga z. Vladimir Gojak nga ACER ku na ka dërguar Fletë konfirmimin “Confirmation Letter” nga z. Tai Chi Shih drejtor i shitjes ndërkombëtare të ACER, për produktin në fjalë dhe se modeli bazik i këtij laptopi është A315-54K ndërsa shifra 361G është numër i përkohshëm, apo temporary part number për projektin konkret, me specifikacionin teknik sipas kërkesës së AK-së. Gjithashtu nga web faqja e ACER, www.acer.com/ac/en/IL/content/models/laptops/aspire3 mund të vërtetoj AK për modelet e laptopit në fjalë me part numër Aspire 3 A315-54K-xxxx.

PROVË: Emaili i datës 01.09.2020 nga z. Vladimir Gojak dhe attachmenti nga ky email “Confirmation Letter” nga z. Tai Chi Shih drejtor i shitjes ndërkombëtare të ACER si dhe modelet e laptopit Aspire 3 nga faqja zyrtare e ACER

AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës e as zyrtarët e saj të prokurimit, nuk janë autoritet e as nuk kanë thirrje, autorizim, kompetencë, aftësi apo pajisje adekuate për të arritur në konstatime të tilla se ne e paskemi falsifikuar katalogun në fjalë, duke tentuar që përveç se të na eliminojnë kundërligjshëm dhe të na shantazhojnë me këto pretendime, edhe të na baltosin dhe të tentojnë të na prishin imazhin e mirë të kompanive pjesëmarrëse në grupin e OE-ve nga kompanitë ARTECH ntsh dhe ERAMED ntp. Për të zhvilluar hetime penale bazuar në KODIN Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE, Nenin 6 Fillimi i procedurës penale, fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale dhe deri më tani, jo që nuk është vërtetuar se kemi të bëjmë me elemente të veprës penale, as me fillimin e hetimeve, e as me kallëzimin penal nga organet publike sipas Nenit 78 të KODIT Nr. 04/L-123 TË PROCEDURES PENALE, e që AK ka qenë e obliguar ti paraqes pranë njërive hetuese të Policisë dhe jo ti përdor ato si mjet shantazhi për ti arritur qëllimet e veta dhe kjo përben vepër penale në vetvete.

Nga provat e prezantuara mund të konstatohet dhe vërtetohet se ne i plotësojmë të gjitha kriteret e përcaktuara nga AK për tu konsideruar si OE e përgjegjshme dhe grupi i OE-ve të shpërblyer me kontratë të konsiderohet si OE e papërgjegjshme.

Nga sa u tha më lartë, duke u bazuar në provat dhe faktet e prezantuara më lartë dhe dëshmitë e bashkangjitura kësaj kërkesë, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e akteve nënligjore, kërkojmë nga AK që ofertën e grupit të OE-ve Aritech shpk dhe Cimi

Electronic shpk të shpërblyer me kontratë ta shpallë si të papërgjegjshëm, ta eliminoj OE në fjalë dhe rrjedhimisht të na shpërblej ne me kontratë, si grup i OE-ve të përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi i shkaktuar nga AK është relativisht i madhe, i cili mbetet të sqarohet në terë në procedurat e mëvonshme, por deri më tani të identifikuar janë si vijon:
Fitimi eventual i humbur: 27'620.00€
Shpenzimet e përfaqësimit: 350.00€
Dëmtim i imazhit të kompanisë: 32'400.00€, etj.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
- b) një kopje të platformës së e-prokurimit me data e publikimit të dokumenteve
- c) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve
- d) B58 – Njoftimi mbi vendimin e AK-së i datës 28.08.2020
- e) B54 – Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm i datës 28.08.2020
- f) B45 – Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar e datës 28.08.2020
- g) ISO Certifikata 9001:2015 nga Cimi Electronic shpk
- h) Nje email nga cimi electronic shpk per EASICC
- i) ISO Certifikata 9001:2015 nga ERAMED NTP me afat të vlefshmerisë
- j) kopje e Manufacturer Authorization Form nga TPVISION i datës 04.05.2020
- k) kopje e katalogut Philips per TV
- l) kopje e Kerkeses per qasje ne dokumentacion dhe Kerkesen per sqarim se pse nuk jemi njoftuar per elimin apo si tenderus i pasuksesshem e datës 28.08.2020
- m) kopje e emailit e datës 30.08.2020 nga AK për lejimin e qasjes ne dokumente
- n) kopje të emaileve e datave 27.04.2020, 16.04.2020, 04.04.2020 (4 faqe)
- o) kopje e Katalogut per Acer Aspire 3 3 faqe
- p) kopje e Emaili i datës 01.09.2020 nga z. Vladimir Gojak
- q) kopje e "Confirmation Letter" nga z. Tai Chi Shih drejtor i shitjes ndërkombëtare të ACER
- r) kopje e sqarimit te Partn numrit për laptopin nga ACER, Aspire 3
- s) kopje e modelet e laptopit Aspire 3 nga faqja zyrtare e ACER

Baza Ligjore

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës në pretendimin e OE – ankimor se Operatori i rekomanduar për dhënie të kontratën nuk përmbush afatin e validitetit për ISO stadandar 9001:2015, Autoriteti Kontraktues konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratën ka përmbushur kriterin për ISO standard 9001:2015, pasi që i njëjti ka dorëzuar edhe emailin e konfirmuar se do të pajisjen me validitet për vitin 2021 ndërsa gjatë ofertimit i njëjti ka pas validitet për vitin 2020.

Provë 1: ISO standard 9001:2015.

EAS INTERNATIONAL

CERTIFICATE

Certificate, No: ER-236-QMS

QUALITY MANAGEMENT SYSTEM
ISO 9001:2015

This Certificate is for:

Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K
Rr. Azem Bejta, Skënderaj, Prishtinë

Assessment scope:
Supply, installation of security system equipment, camera, electrical systems, automatic systems.

Date of Certificate Issue: 02.07.2019
Certificate Valid Until: 01.07.2020

Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance.

Directly online in official webpage: www.easicc.com/er/236qms or email info@easicc.com

 **Exzellent**
Quality certified
#The Excellence, International registration

 **British Quality**
FOUNDATION
MEMBER
BQF – No: 57874


Authorized Signature

This certificate is issued by EAS International process of technical inspection and analyses and accredited based on ISO 17021.
EAS-SEE Services: RM, Skopje, Nikola Rusinski 67, T: 00 389 2 521 5000, www.easicc.com, EAS is a member of BQF.
33339.Ltd.018.uk. *Document model in English language, Page: 1-1

Behar Gerguri

From: cimiELECTRONIC shpk <cimielectronicshpk@gmail.com>
Sent: Tuesday, June 2, 2020 11:03 AM
To: behar@aritech-ks.com
Subject: Fwd: Urgent request

----- Forwarded message -----

From: EAS ICC <eas.icc@gmail.com>
Date: Tue, Jun 2, 2020 at 11:01 AM
Subject: Re: Urgent request
To: cimiELECTRONIC shpk <cimielectronicshpk@gmail.com>, <info@easicc.com>

Dear All,

Based on your request, we as a certification body inform you that according to the rules of the International Organization for Standardization (ISO), your certificate with number ER-236-QMS is valid until 01.07.2020. The maintenance of the certificate is done at the request of the client and before the expiration date.

We as the certification body inform you that we will perform the audit according to your request so that your certificate is valid until 2021.

Thank you for your request.

Kind Regards,
Lejla.
Quality Manager for EAS International.

On Mon, Jun 1, 2020, 23:11 cimiELECTRONIC shpk <cimielectronicshpk@gmail.com> wrote:

Dear All

Our esteemed company is the customer and please request more than ISO 9001: 2015, with number 57874, valid until 01.07.2020,

We would like to participate in an activity, but the request has been valid until the end of the 2020 Visit.

We request that you confirm that you support us in the validity of this certificate (Audit).

Please provide us with a confirmation letter that you will verify our validity and certify what we express interest in and confirm the validity from 01.07.2020- 01.07.2021. The request is urgent in search for dt.02.06.2020 at 11:00

Please have our understanding

--

Me respekt !!!!

cimiELECTRONIC


Adresa: Rr.Azemi Bejta Skenderaj

Ndërsa sa i përket konstatimit se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka përmbushur katalogun, Autoriteti Kontraktues konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka përmbushur katalogun me të gjitha specifikimet dhe është vlerësuar edhe me programin mbi evidentimin e falsifikemve të katalogjeve si dhe kërkimeve në web search official lidhur me modelin e ofertuar TV Philips dhe Kompjuterave me ç'rast ka konstatuar që pas verifikimit të detajuar katalogu me web search official dhe web zyrtar të prodhuesit është në rregull.

Poashtu sa i përket pretendimit se ju si Operator ekonomik ankimor keni sjellur katalogun në mënyrë të drejtë dhe jo të falsifikuar, Autoriteti Kontraktues pas verifikim të hollësishëm me programe të sofistikuara për falsifikim të dokumenteve dhe qasjes direkte në website të Acer poashtu askund modeli i ofertuar nga ana e juaj Acer Aspire 3 modeli: (A315-54K-361G) nuk gjendet në website zyrtar gjë e cila e konfirmon edhe nga ana e juaj që nuk keni sjellur asnjë dëshmi mbi ekzistimin e këtij modeli por keni thënë se ka modele A315-54k-xxxx) dhe gjithashtu ndërhyrjen e juaj si operator për modifikim të katalogut të mbrojtur zyrtar ku fjalia GRAPHIC CARD – (është origjinale e shkruar – kartelë grafike) ju keni modifikuar dhe e keni shkruar GRAFIC CARD. Kjo vërteton qartazi se ju keni bërë falsifikim të dokumentit zyrtar.

Provë 2: Katalogu i falsifikuar ACER ASPIRE 3 - (A315-54K-361G)

- Processor: Intel® Core™ i3-8130U
- Display: 15,6" Full-HD (matt)
- RAMMemory: 4GBDDR4RAM
- Mass storage: 512 GB PCIe SSD
- Grafic Card: Intel® UHD Graphics 620
- Operating System: Windows 10 (64 Bit)



Acer Aspire 3

(A315-54K-361G)



- Processor: Intel® Core™ i3-8130U
- Display: 15,6" Full-HD (matt)
- RAM Memory: 4GB DDR4 RAM
- Mass storage: 512 GB PCIe SSD
- Grafic Card: Intel® UHD Graphics 620
- Operating System: Windows 10 (64 Bit)



Information Drives

Model	Acer Aspire 3
Temp P/N	A315-54K-361G
Acer P/N	NX.HEEV.00F
EAN	4710180802825
Short description	15,6" Full-HD (matt) / Intel® Core™ i3-8130U / 4 GB DDR4 RAM / 512 GB PCIe SSD / Intel® UHD Graphics 620 / Windows 10 / Black

Storage and

Memory	4 GB DDR4 RAM
Memory allocation	1 x 4 GB DDR4 RAM (onboard) DDR4 RAM
Maximum Memory	12 GB DDR4 RAM (4 GB onboard + 1 x 8 GB soDIMM)
Mass storage	512 GB M.2 PCIe Solid-State-Drive (SSD)
Optical Drive	-

OS System

OS System	Windows 10 Pro (64 Bit)
-----------	-------------------------

Graphic Card

Graphic Card	Intel® UHD Graphics 620
--------------	-------------------------

Casing

Casing/ Color	Black
Serviceklappe	-
Dimensions weight	363,4 x 247,5 x 19,95 mm (B x T x H) 1,9 Kg

Passively cooled (fanless)	-
----------------------------	---

Connection

LAN	10/100/1000 LAN, Wake-on-LAN ready
Wireless LAN	802.11 ac/a/b/g/n
Wireless WAN / SIM-Card	- / -
Wireless Gigabit	-
Bluetooth	Bluetooth® 4.0

NFC	-
-----	---

Display

Display size	15,6 inch (39,62 cm)
Display type	Acer ComfyView™ Full HD Display mit LED-Backlight (matt)
Display resolution in pixel	1.920 x 1.080
Aspect ratio	16:9

Processor und Chipset

Processor	Intel® Core™ i3-8130U Processor
Clock frequency	2,2 GHz (up to 3,4 GHz boost frequency)
Cache	4 MB
Number of processor cores / Threads	2 / 4
Chipset	Integrated SOC

IO Connections

HDMI	1x
VGA	-
Displayport	-
Thunderbolt	-
USB 3.2	-
USB 3.1	-
USB 3.0	1x
USB 2.0	2x
Ethernet (RJ-45)	1x
Card reader	-
Audio connection	1x speaker / headphones / line-out (supports headsets with integrated microphone)
Docking Connector	-

Neni 390

Falsifikimi i dokumenteve

- 1. Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër (4) vjet.**
- 2. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet në lidhje me dokumentin publik, testamentin, kambialin, regjistrin publik apo zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.**
- 3. Kushdo që e kryen veprën e paraparë në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni si anëtar i grupit të njerëzve, dënohet me gjobë dhe burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.**

Neni 391

Rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve

- 1. Personi do të konsiderohet se ka kryer vepër penale të falsifikimit të dokumenteve dhe do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë:**
 - 1.1. pa autorizim plotëson ndonjë letër, formular të zbrazët ose ndonjë formë tjetër në të cilën është vënë nënshkrimi i personit tjetër dhe plotëson deklaratën përmes së cilës krijon marrëdhënie juridike;**
 - 1.2. mashtron personin tjetër lidhur me përmbajtjen e ndonjë dokumenti dhe personi i tillë e nënshkruan këtë dokument duke menduar se nënshkruan ndonjë dokument tjetër ose dokument me ndonjë përmbajtje tjetër.**

Poashtu ju si Operator ekonomik ankimor keni dorëzuar ISO Standard 9001:2015 nga ERAMED për pajisje mjekësore që me asgjë nuk lidhet me teknologji informative siç janë kamerat e sigurisë, pajisjet teknologjike informative, pajisjet elektrike etj.

Provë 3: ISO STANDARD 9001:2015 - ERAMED



Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
Kosovo Medicines Agency
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva

Në bazë të Ligjit 04/L-190 për produkte dhe pajisje medicinale dhe UA Nr.13/2013, AKPPM lëshon:
Na osnovu zakona br. 04/L-190 i AU Br.13/2013, KALIMS izdaje:
Referring to the Law Nr. 04/L-190 and AI No 13/2013, Ministry of Health through KMA issues:

Licencë veprimtarie

Qarkullues me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale
Dozvola za veleprodaju lekova i medicinskih sredstva
License as a wholesaler for medical products and devices

Nr. i licencës / License No / Br. Dozvole:
L1/2016/03/0238

Kompania / Company / Kompanija:
ERAMED

Adresa / Address / Adresa:
Fshati "Shkabaj" Obiliq, R e Kosovës

Licenca është valide nga data **01.03.2016** deri me datën **01.03.2021**, vetëm nëse përtëritja vjetore nga shtojca 1 e kësaj licencë është valide.

Licenca je važeća od datuma 01.03.2016 do datuma 01.03.2021, samo uz validnim godišnjim obnavljanjem sa prilogom 1 ove licence.

The licence is valid from the date 01.03.2016 up to date 01.03.2021, only if annual renewal by Annex 1 of this license is valid.

Shtojcë e licencës / Prilog licence / Anex of license:

Adresa e objektit, personeli, zgjerimi i veprimtarisë, ndryshimet eventuale, etj

Adresa objekata, osoblje, proširenje delatnosti, eventualne promene itd.

Building address, personnel, expansion of the activities, changes, etc.



Drejtör i Departamentit të Licencimit
Head of Licensing / Direktor Licenciranja

Dr.spc.Dukagjin Zabërgja


Kryeshef Ekzekutiv i AKPPM-së
Chief Executive officer / Izvršni Direktor

Pharm-D Jeton Shala



Ndërsa sa i përket letër sqarimit për Manufacturint Authorization Form – MAF nga prodhuesi ju keni dorëzuar dëshmi nga ACER nga drejtori gjeneral për Ballkanin z. Vladimir Gojak ndërsa nuk keni dorëzuar letër sqarimin nga Drejtori TAI CHI SHIH.

Provë 3: Letër standarde për sqarim të dosjes së tenderit të datës 17.07.2020.



SQARIME SHITES

N.T.SH " ARTECH "
Bajram Kelmendi NR 45 E
Pristina, 10000
Republic of KOSOVO
Tel. +381 38 223 562
Mob. +377 45 654 000
E-mail: info@artech-ks.com

www.artech-ks.com

SQARIME SHITES

Ne Operatori ekonomik N.T.SH ARTECH me NRI 810916934 dhe Nr. fiskal 600759669 kemi pranuar permes platformes e-prokurimi, Leter Standarde per sqarimin e tenderit nga ju, Komuna e Prishtines per tenderin me numer te prokurimit 616-201-154-111 me Titull : Furnizim me pajisje teknologjike per institucionet arsimore, me daten 17.07.2020 ne ora 10:28.

Ku ju kerkoni qe te ju derzoim nje email zyrtar ne gjuhen angleze per konfirmimin e Autorizimit te Prodhuesit nga nenshkrusi i keti Autorizimi.

Prandaj ne kete sqarim shites ju keni si prova te bashkangjitura emailin ku deshmohet se autorizimi ne fjale eshte derguar nga Drejtori i Acer per regjionin e ballkanit.

Sa i perket keti konfirmim te kerkuar nga ju ne kemi kontraktuar me prodhuesi dhe kemi kerkuar zyrtarisht te ju dergohet ky konfirmim direkt tek ju ne email e juaj nga zyrtaret e prodhuesit Acer gjegjesisht drejtori per regjionin tone.

Po ashtu ne kete sqarim shites e keni te bashkangjitur edhe email nga drejtori i Acer per regjioni ku eshte konfirmi i kerkuar nga ju per MAF te leshuar ne Acer.

Data: 17.07.2020

V. V



Authorized
Distributor

alhua

ZKTeco

stellar

netis

Kasda

CamBox

ur-nium

ARMAGAN

ades

LEISUS

tsinepower

necron

albanbikliqi@artech-ks.com

From: Mislav.Jagunic@acer.com
Sent: Friday, July 17, 2020 2:27 PM
To: flamur.sallahu@rks-gov.net
Cc: albanbikliqi@artech-ks.com
Subject: Confirmation of MAF - company Artech N.T.SH.
Attachments: MAF Artech Municipality.pdf

Dear Sir,

this is to confirm that attached MAF issued to company Artech N.T.SH. from ACER Sales International SA, to participating on the public tender for Municipality of Prishitna – Republic of Kosova is valid.

Best regards,

Mislav Jagunić
Head of Representative Office | Adriatic Region
Acer Representation in Croatia
Email: mislav.jagunic@acer.com | Phone: +385 1 5005 070 | Mobile: + 385 91 3899 099

Follow us: [facebook/AcerHrvatska](https://facebook.com/AcerHrvatska) | [facebook/AcerSrbija](https://facebook.com/AcerSrbija) | [facebook/AcerSlovenija](https://facebook.com/AcerSlovenija) | [facebook/AcerMacedonia](https://facebook.com/AcerMacedonia)



=====

This email contains information that is for the sole use of the intended recipient and may be confidential or privileged. If you are not the intended recipient, note that any disclosure, copying, distribution, or use of this email, or the contents of this email is prohibited. If you have received this email in error, please notify the sender of the error and delete the message. Thank you.

=====!!

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

